Lënda synon të përcjellë njohuritë bazë mbi metodat e komunikimit duke përdorur format konvencionale, sistemet tradicionale radio dhe teknologjinë bashkëkohore të GMDSS për fatkeqësitë, urgjencat dhe situatat rutinë të lundrimit. Gjithashtu synohet përcjellja e njohurive mbi pajisjet elektronike dixhitale dhe jo-dixhitale që përdoren në radiokomunikimin detar, kuadrin ligjor ndërkombëtar për komunikimet si dhe proçedurat e komunikimit dixhital dhe satelitor.

Përmbajtja e lëndës:

Tema I: Temat që do trajtohen në leksione:

1. RADIOKOMUNIKIMI DETAR; Alfabeti Fonetik Ndërkombëtar dhe Kodi Mors
2. Kodi Ndërkombëtar i Sinjaleve K.N.S.Proçedurat e Transmetimit,sinjalizimet sipas K.N.S; Koncepte të Përgjithshme
3. Struktura e Kodit, Sinjalet me një Gërmë, Sinjalet Dy Gërmëshe (pjesa e përgjithshme)
4. Seksioni Mjeksor, Sinjalet e Shpëtimit
5. Komunikimet ndërmjet akullthyeseve dhe anijeve që kërkojnë ndihmë, KODI Q, Sinjalet e Kodit Q
6. Evolucioni i radiokomunikimit detar, GMDSS; Global Maritime Distress And Safety System (Konfigurimi i GMDSS-it)
7. Sistemet e Radiokomunikimit në përbërje të GMDSS-it, SISTEMI INMARSAT; (International Maritime Satelite)
8. INMARSAT Standart-A dhe Standart-B , INMARSAT STANDART - C dhe shërbimi EGC
9. Sistemi COSPAS-SARSATSART-i;SART-i; (Search And Rescue Radar Transponder)
10. EPIRB-i; Shërbimi NAVTEX
11. SISTEMI D.S.C. (Digital Selective Call)Mesazhet në DSC
12. Sistemi Automatik i Identifikimit, (AIS), Struktura dhe funksionimi sistemit AIS
13. Informacionet nautike që përcillen me radiokomunikim, Shërbimet ndërkombëtare bregdetare dhe në distancë të largët
14. Konventa SOLAS74 dhe radiokomunikimi, Konventa S.A.R. (1979) dhe radiokomunikimi
15. ITU, Konventa dhe dispozitat e saj në funksion të radiokomunikimit, Rrjetet e telekomunikacionit dhe menaxhimi i informatizuar i sistemeve të emergjencës

Tema II: Temat që do trajtohen në seminare:

1. RADIOKOMUNIKIMI DETAR; Alfabeti Fonetik Ndërkombëtar dhe Kodi Mors
2. Kodi Ndërkombëtar i Sinjaleve K.N.S.Proçedurat e Transmetimit,sinjalizimet sipas K.N.S; Koncepte të Përgjithshme
3. Struktura e Kodit, Sinjalet me një Gërmë, Sinjalet Dy Gërmëshe (pjesa e përgjithshme)
4. Seksioni Mjeksor, Sinjalet e Shpëtimit
5. Komunikimet ndërmjet akullthyeseve dhe anijeve që kërkojnë ndihmë, KODI Q, Sinjalet e Kodit Q
6. Evolucioni i radiokomunikimit detar, GMDSS; Global Maritime Distress And Safety System (Konfigurimi i GMDSS-it)
7. Sistemet e Radiokomunikimit në përbërje të GMDSS-it, SISTEMI INMARSAT; (International Maritime Satelite)
8. INMARSAT Standart-A dhe Standart-B , INMARSAT STANDART - C dhe shërbimi EGC
9. Sistemi COSPAS-SARSATSART-i;SART-i; (Search And Rescue Radar Transponder)
10. EPIRB-i; Shërbimi NAVTEX
11. SISTEMI D.S.C. (Digital Selective Call)Mesazhet në DSC
12. Sistemi Automatik i Identifikimit, (AIS), Struktura dhe funksionimi sistemit AIS
13. Informacionet nautike që përcillen me radiokomunikim, Shërbimet ndërkombëtare bregdetare dhe në distancë të largët
14. Konventa SOLAS74 dhe radiokomunikimi, Konventa S.A.R. (1979) dhe radiokomunikimi
15. ITU, Konventa dhe dispozitat e saj në funksion të radiokomunikimit, Rrjetet e telekomunikacionit dhe menaxhimi i informatizuar i sistemeve të emergjencës

Tema III : Temat që do trajtohen në detyrë kursi:

16. GMDSS;
17. SISTEMI INMARSAT;
18. Sistemi COSPAS-SARSATSART-i;
19. SART-i;
20. EPIRB-i;
21. Sherbimi NAVTEX
22. SISTEMI D.S.C.
23. Sistemi Automatik i Identifikimit, (AIS)
24. Sistemi MAREM
25. Sistemi VTS
26. Sistemi VMS
27. Sistemi HAZMAT

Literatura bazë:

- Cikli i leksioneve të: **"RADIOKOMUNIKIM DETAR"**

Literatura ndihmëse:

- International Convention on Standards of Training, Certification and Watchkeeping for Seafarers (STCW), 1995 (IMO Sales No. 938), and 1997 Amendments to STCW 95 (IMO Sales No. 945)
- IMO (2006). International Convention on Safety of Life at Sea, London, IMO Publications
- IMO (1985). International Code of Signals, London, IMO Publication Admiralty List of Radio Signals (2003-2004). Volume 5, London, British Publications
- GMDSS Handbook, Handbook on the Global Maritime Distress and Safety System; INTERNATIONAL MARITIME ORGANIZATION 4 Albert Embankment, London SE1 7SR; 3rd Edition, 2001; (2 4 6 8 10 9 7 5 3 1) ISBN 92-801-5098-7; Sales number: IMO-970E.
- Manual for the Maritime Mobile and Maritime Mobile – Satellite Services (1998) IMO (2000). Search and Rescue Transponder (SART), London, United Kingdom 2000

FORMAT E VLERËSIMIT TË STUDENTËVE:

Kontrolli	Vlerësimi në përqindje
Kontrolli I	25 %
Kontrolli II	30%
Vlerësimi vjetor dhe Detyrë Kursi	10 %
Kontrolli final	35 %

Vlerësimi me notë behet në bazë të konvertimit të vlerësimit total në %, nota 5-10 progresivisht 40-100%
Studenti, që rezulton më pak se 75% frekuentim për periudhën që i përket çdo provimi të pjesshëm, periudhë për të cilën do të testohet, nuk do të futet në provimin përkatës, do të vlerësohet me M.
Nëse studenti ka frekuentuar kursin, por nuk paraqitet në provimin e radhës vlerësohet NP (Nuk u Paraqit).

Formati i lëndës:
Lënda do të vlerësohet mbi bazën e dy provimeve të pjesëshme, vlerësimit vjetor, detyrës së kursit dhe provimit final. Pikët e marra do të jenë kumulative. Provimet nuk ripërsëriten, për asnjë motiv. Nëse ju do të humbisni një provim pa një arsye madhore, atëherë ju do të humbisni pikët për atë provim në të cilin nuk u paraqitët.

Komunikimi:
Ushtrimet e detyrave të shtepisë, detyra e kursit dhe çdo njoftim tjetër do të jepet në klase dhe/ose në adresën zyrtare të Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës në internet: www.univlora.edu.al apo në adresën elektronike të pedagogut suard.alizoti82@gmail.com

Email: çdo student e ka për detyrë të kontrollojë rregullisht e-mailin. Do të ketë detyra dhe njoftimet do të jepen vetëm nëpërmjet e-mailit.

Kodi i ndershmërisë:
Nuk lejohet puna në grupe për detyrat e shtëpisë, pasi ato janë individuale. Njëkohësisht nuk lejohet edhe kopjimi në provime,i cili ndëshkohet.

SYLLABUS DET325 Praktikë Lundrimore

Pedagogu: MSc. Suard Alizoti
Semestri Pranverë 2015
Ngarkesa javore: 0 lex/5sem
Kredite: 5

Objektivat e lëndës:

Praktika Lundrimore do të shtrihet përgjatë fazës finale të semestrit për një periudhë dy javore. Kjo lëndë ka për qëllim krijimin e aftësive praktike të studentëve në përdorimin e njohurive të marra në lëndët profesionale që lidhen me lundrimin, drejtimin e anijes dhe aktivitetet e tjera që kryhen në bord.

Përmbajtja e lëndës:
Tema I: Temat që do trajtohen në leksione:

-

Tema II: Temat që do trajtohen në seminare (Praktikë në bord):

1. Hartat Detare Lundrimore; Publikimet për Navigatorët;
2. Pajisjet navigacionale dhe radionavigacionale ;
3. Dokumentacioni shoqërues i shtrimit grafik në hartën detare;
4. Trajtimi i elementëve të punës në hartën detare;
5. Detyra Lundrimore Nr.1; Siguria e lundrimit;
6. Detyra Lundrimore Nr.2; Fenerët lundrimorë; Sistemi i dritave të lundrimit të anijes;
7. Elementët e identifikimit dhe dokumentacioni i anijes
8. Dokumentacioni i identifikimit dhe i kompetencave të detarit;
9. Përgatitja e anijes për lundrim;Përgatitja e anijes për hedhjen e spirancës;
10. Pajisjet e akostim-çakostimit të anijes; Përgatitja e anijes për manovra akostim – çakostimi;
11. Përgatitja e anijes për lundrim në kushte të veçanta; Rënia e anijes në cekinë;
12. Manovrimi i anijes për akostim-çakostim; Zbatim praktik i manovrimit të anijes; Masat për shpëtimin e jetës së njeriut jashtë bordit;
13. Lufta kundër zjarrit në anije; Parimet bazë të kujdesit për jetën, Administrimi i ndihmës bazë për jetën
14. Lufta kundër ujit në anije, Pajisjet e sigurimit të ngarkesës në bord
15. Komandim-Kontrolli

Literatura bazë dhe ndihmëse:

-

FORMAT E VLERËSIMIT TË STUDENTËVE:

Kontrolli	Vlerësimi në përqindje
Kontrolli I	0 %
Kontrolli II	0%
Vlerësimi vjetor	0 %
Kontrolli final	100 %

Vlerësimi me notë behet në bazë të konvertimit të vlerësimit total në %, nota 5-10 progresivisht 40-100%
Studenti, që rezulton se nuk ka frekuentuar aktivitetin e praktikës në bord gjatë periudhës së përcaktuar dyjavore, do të vlerësohet me M.

Formati i lëndës:
Lënda do të vlerësohet mbi bazën e provimit final. Provimi nuk ripërsëritet, për asnjë motiv. Nëse ju do të humbisni provimin pa një arsye madhore, atëherë ju do të humbisni pikët për atë provim.

Komunikimi:
Çdo njoftim në lidhje me praktikën lundrimore do të jepet në klasë dhe/ose në adresën zyrtare të Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës në internet: www.univlora.edu.al apo në adresën elektronike të pedagogut suard.alizoti82@gmail.com

Email: çdo student e ka për detyrë të kontrollojë rregullisht e-mailin. Do të ketë detyra dhe njoftimet do të jepen vetëm nëpërmjet e-mailit.

SYLLABUS ENG 132 (Shkenca Teknike)

Pedagogu: Dr.Evis CELO
Semestri Vjeshte 2014
Ngarkesa javore: 3 lex/2 sem
Kredite: 6

Objektivat e lendes:

Plani është programuar për studentë të SHKENCAVE teknike, kryesisht studentët duhet të riforcojne atë që kanë mësuar më parë dhe njëkohesisht duhet të dini terminologjnë e duhur për një karrierë të mëpasshme në shkencat Teknike. Ky libër është i hapur për studentët e shkencave-teknike.
Ai gjithashtu ju jep studentëve njohuritë për gjuhën bazë, informacionin dhe aftësitë që ju duhen për të filluar një karrierë në punësim.Në bazë të interesit të tyre dalin aftësive ndërpersonale kryesore për lidhjet e njohuritë me risitë e fundit teknologjike. Fakte, shifra, interesat dhe karriera janë të mbështjella në librin e prezantuar për të pasuruar fjalorin e studentit, për të rishikuar aftesitë gjuhësore dhe riciklimin e gjuhës me terma të inxhinierisë.

Përmbajtja e lëndës:

Tema I: Puna dhe inxhinieria. Gramatikë format "ING "dhe "To" te infinitivit
46. Të realizosh një projekt ixhinierik.
47. Ushtrime leksikore-gramatikore

Tema II: Agrikultura dhe transporti:
16. Gramatike koha e tashme e thjeshtë.
17. Precizioni në proceset agrikulturore.

Tema III : Urat and tunelet –Inxhinieria e tyre

28. Gramatikë koha e tashme e vazhduar
29. Ushtrime. Spote teknikash.

Tema IV : Inxhinieria Plastike.
1. Historia and vecorite e plastikës
2. Gramatikë, foljet e Aftesisë,domosdoshmërisë dhe të mundesisë

Tema V: Energjia Alternative.

1. Gramatikë koha e kryer e thjeshtë .
2. Energjia Inovative

Tema V**I.** Aeronautika .Gramatikë:

1. Fjalia kushtore e parë dhe e dytë
2. Projekt mbi termat e energjisë
3. Diagrama makinës fluturuese

Tema V**II**. Shtepitë e të ardhmes.Gramatikëfoljet Obligatore *Have to; Must*

1. Ushtrime leksikore-gramatikore
2. Projekte mbi Shtepitë e te ardhmes

Tema V**III** . Transporti masiv.
1. Gramatike ,emrat dhe mbiemrat e përbërë
2. Përforcime
3. Ushtrime leksikore-gramatikore
4. Projekte Evropiane

Tema IX . Petroliumi and Inxhinieria.
1. Përsëritje e kohëve të gjuhës angleze.
2. Teknologjia e Petroliumit

Tema X**.** Inxhinieria ambjentaliste
1. Gramatikë ,shprehjet e kohës.
2. Ushtrime leksikore-gramatikore

Tema XI **.**Robotika
1. Foljet shkakore dhe pësore me , come to, make, prevent, allow, enable to, let.
2. Ushtrime leksikor-gramatikor

Tema XII**.** Teknologjia e ndërtimit të shtëpive

1. Gramatike, përsëritje dhe pyetjet me " Wh .."
2. Ushtrime leksikor-gramatikor

Tema XIII**.** Teknologjia e mbrojtjes.

1. Gramatikë, koha e ardhme.
2. Elektronika

Tema XIV.Gramatike,përsërtje koha e tashme ,e ardhme

1. Ushtrime leksikore-gramatikore

Tema XV**.** Zhvillimi i karrierës

1. Gramatikë,përsëritje koha e tashme ,e ardhme dhe përsëritje e përgjithshme

Literatura bazë dhe ndihmëse:

- "Technology 2" By Eric .H.Glendinning and Alison POHL- ISBN 10: 0194569535 / 0-19-456953-5 Oxford English for Career , University Publishers 2012-2013
- www.oup .com/elt/oefc (extra internet materials)

FORMAT E VLERESIMIT TE STUDENTEVE:

Kontrolli	**Vleresimi ne perqindje**
Kontrolli I	25 %
Kontrolli II	25%
Vleresimi vjetor	10 %
Kontrolli final	40 %

Vleresimi me note behet ne baze te konvertimit te vleresimit total ne %, nota 5-10 progresivisht 41-100%
Studenti, qe rezulton me pak se 75% frekuentim per periudhen qe i perket cdo provimi te pjesshem, periudhe per te cilen do te testohet, nuk do te futet ne provimin perkates, do te vleresohet me M.
Nese studenti ka frekuentuar kursin, por nuk paraqitet ne provimin e radhes vleresohet NP (Nuk u Paraqit).

Formati i lëndës:

Kursi do te vleresohet mbi bazen e dy provimeve të pjesëshme, detyrave si dhe provimi final. Pikët e marra do të jenë kumulative. **Nuk do te ripërsëriten provimet, për asnje motiv**. N.q.s. ju do të humbisni një provim pa një arsye madhore, atëherë ju do të humbisni pikët për atë provim në të cilin nuk u paraqitët. Për çdo provim ju do të jeni të paralajmëruar nga ana ime se kur do të zhvillohen ato.

Komunikimi:

N.q.s. ju keni ndonjë problem apo pyetje, ju lutem dërgoni e-mail me subjektin "MKT 110".
N.q.s. ju keni ndonjë problem apo pyetje, ju lutem njoftoni ne sekretarine e universitetit
Telefonatat në numrin tim personal fiks apo celular nuk janë të përshtatëshme: do t'ju lutesha të mos i përdorni ato. Përpara se të bëni një pyetje, sigurohuni se këtë informacion ju nuk e keni gjetur në faqen zyrtare të internetit të UV. Ju lutem mos drejtoni pyetje rreth përmbajtjes së kursit, pasi pyetjeve të tilla preferoj t'u përgjigjem në auditor në praninë e një mase të gjerë studentësh.

Email: Çdo student e ka për detyrë të kontrollojë rregullisht e-mailin. Shumë detyra dhe njoftime do të jepen vetëm nëpërmjet e-mailit.

Kodi i ndershmërisë:

Nuk lejohet puna në grupe për detyrat e shtëpisë, pasi ato janë individuale. Njëkohësisht nuk lejohet edhe kopjimi në provime, i cili ndëshkohet.

SYLLABUS CST 130 Teknologji Informacioni dhe Komunikimi

Pedagogu: Anila Ismailaj
Semestri Pranverë 2015
Ngarkesa javore: 3 lex
Kredite: 4

Objektivat e lëndës:
Në temat e trajtuara në këtë kurs theksohet rëndësia e kompjuterit dhe shkencës së informatikës në ditët e sotme. Njihemi me konceptet kryesore të TIK-ut: harduer, softuere, rrjetat kompjuterike dhe interneti, siguria e te dhenave, etj. Një objektiv tjetër thelbësor i këtij kursi është njohja dhe përdorimi i programeve bazë të paketës Microsoft Office.

Përmbajtja e lëndës
Tema I: Temat që do trajtohen në leksione:

48. Konceptet e teknologjisë së Informacionit dhe komunikimit
49. Kompjuteri, ndërtimi dhe funksionet
50. Pajisjet hyrëse/dalëse
51. Programet, llojet, klasifikimi i tyre
52. Sistemet e operimit Windows
53. Microsoft Word 2007
54. Microsoft Word 2007
55. Microsoft PowerPoint 2007
56. Microsoft Excel 2007
57. Microsoft Excel 2007
58. Rrjetat kompjuterike
59. Interneti, Posta elektronike, Kërkimi në Internet
60. Hyrje në algoritmikë
61. Hyrje në programim
62. Hyrje në Gjuhen C

Tema III : Temat që do trajtohen në detyren e kursit:

30. Tema e detyrës së kursit do të jetë individuale përçdo student dhe do të përcaktohet në javën e 10-të

Literatura bazë dhe ndihmëse:

- ECDL; Modulet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7
- "Elementet e Informatikes" , Betim Cico, Hakik Paci
- Gjuha C, Betim Cico, Hakik Paci
- Dispencë leksionesh "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi", Anila Ismailaj

FORMAT E VLERËSIMIT TË STUDENTËVE:

Kontrolli	Vlerësimi në përqindje
Kontrolli I	25 %
Kontrolli II	25 %
Vlerësimi vjetor	10 %
Kontrolli final	40 %

Vleresimi me notë bëhet në bazë të konvertimit të vleresimit total në %, nota 5-10 progresivisht 41-100%
Studenti, që rezulton me më pak se 75% frekuentim për periudhen që i përket çdo provimi të pjesshëm, periudhe për të cilën do të testohet, nuk do të futet në provimin përkatës, do të vlerësohet me M.
Nëse studenti ka frekuentuar kursin, por nuk paraqitet në provimin e radhës vlerësohet NP (Nuk u Paraqit).

Formati i lendës:
Lënda do të vlerësohet mbi bazën e dy provimeve të pjesëshme, detyrave si dhe provimi final. Pikët e marra do të jenë kumulative. Nuk do te ripërsëriten provimet, për asnje motiv. Nëse ju do të humbisni një provim pa një arsye madhore, atëherë ju do të humbisni pikët për atë provim në të cilin nuk u paraqitët.

Komunikimi:
N.q.s. ju keni ndonjë problem apo pyetje, ju lutem dërgoni e-mail me subjektin "CST 130".
Telefonatat në numrin personal fiks apo cellular te pedagogut te lendes nuk janë të përshtatëshme: do t'ju luteshim të mos i përdorni ato. E-mail mund të zgjasë disa ditë për t'ju kthyer përgjigje. Shkruani subjektin "CST 130 Urgjent" n.q.s problemi juaj është urgjent dhe nuk mund të presë. Studentet jane te lutur te mos dërgojnë e-mail që ka lidhje me kursin pa subjektin: CST 130. Përpara se studentet të bëjnë një pyetje, të sigurohen se këtë informacion nuk e kanë gjetur në faqen zyrtare të internetit të UV. Studentet jane te lutur te mos drejtojnë nërpermjet email-it pyetje rreth përmbajtjes së kursit, pasi pyetjeve të tilla eshte mire tu jepet përgjigje në auditor, në praninë e një mase të gjerë studentësh.

Email: Çdo student e ka për detyrë të kontrollojë rregullisht e-mailin. Do te kete detyra dhe njoftime do të jepen vetëm nëpërmjet e-mailit.

Kodi i ndershmërisë:

Nuk lejohet puna në grupe për detyrat e shtëpisë, pasi ato janë individuale. Njëkohësisht nuk lejohet edhe kopjimi në provime, i cili ndëshkohet.

SYLLABUS MAT 154 Kalkulus 1

Pedagogu: MSc. Anila Duka
Semestri Vjeshtë 2014
Ngarkesa javore: 3 lex/2sem
Kredite: 8

Objektivat e lëndës:
Programi synon të japë një studim të plotë të funksionit duke trajtuar bashkësinë e tij të përcaktimit, çiftësinë, monotoninë dhe ekstremumet duke vazhduar më tej me limitin e funksionit, vazhdueshmërinë e tij, diferencimin dhe integrimin e funksionit të një variabli, rregullat e derivimit dhe aplikime të derivatit, format e pacaktuara dhe rregulli I l'Hopital-it,etj.

Përmbajtja e lëndës:
Tema I: Temat që do trajtohen në leksione:

63. Funksionet dhe modelet matematike.Ekuacionet jo-lineare. Funksionet monotone, funksionet rritës dhe funksionet zbritës. Diferencimi. Disa klasa të rëndësishme funksionesh.
64. Transformimet dhe kombinimet e funksioneve. Funksionet inverse. Përsëritje.
65. Problemi i tangjentes dhe shpejtësisë. Limiti i funksionit. Limitet e njëanshme dhe limitet e pafundëm.
66. Përkufizimi i saktë i limitit. Rregullat e kalimit në limit. Përsëritje
67. Vazhdushmëria. Limitet në pikat e pafundme. Tangentet, shpejtësitë, dhe raportet e tjera të ndryshimit.
68. Përkufizimi i derivatit. **PROVIMI I.** Interpretimi i derivatit si raport ndryshimi .
69. Derivati i një funksioni. Derivatet e funksioneve elementare. Funksionet exponenciale.
70. Rregulla të tjera të derivimit. Derivimi i funksioneve trigonometrike. Derivimi i funksionit të përbërë, rregulli zinxhir.
71. Derivimi në mënyrë implicite. Derivatet e rendeve të larta. Përafrimet Lineare dhe diferencialet.
72. Vlerat maksimum dhe minimum. Teorema e vlerës së mesme. **PROVIMI II**
73. Përcaktimi i grafikut nëpërmjet derivatit. Format e pacaktuara, rregulli i L'Hopital-it. Studimi i plotë i një funksioni nëpërmjet derivateve.
74. Problemet e optimizimit. Metoda e përafrimit e Njutonit. Antiderivatet
75. Sipërfaqet dhe distancat. Integrali i caktuar. Teorema themelore e kalkulusit.
76. Integralet e pacaktuara. Përsëritje. Metoda e zëvendësimit.
77. Logaritmi i përcaktuar si integral. **PROVIMI III**

Tema II: Temat qe do trajtohen ne seminare:

18. Funksionet . Funksionet monotone, rritës dhe funksionet zbritës. Ekuacionet jo-lineare. Disa klasa të rëndësishme funksionesh.
19. Transformimet dhe kombinimet e funksioneve. Diferencimi. Funksionet inverse
20. Problemi i tangjentes dhe shpejtësisë. Limiti i funksionit. Limitet e njëanshme dhe limitet e pafundëm
21. Përkufizimi i saktë i limitit. Rregullat e kalimit në limit. Vazhdushmëria
22. Limitet në pikat e pafundme. Tangentet, shpejtësitë dhe raportet e tjera të ndryshimit. Përkufizimi i derivatit. Interpretimi i derivatit si raport ndryshimi. Derivati si një funksion.
23. Derivatet e funksioneve elementare. Funksionet eksponencial. Rregulla të tjera të derivimit
24. Përsëritje. Derivimi i funksioneve trigonometrike.
25. Derivimi i funksionit të përbërë, rregulli zinxhir. Derivimi në mënyrë implicite
26. Derivatet e rendeve të larta. Diferencialet. Vlerat maksimum dhe minimum. Teorema e vlerës së mesme
27. Përcaktimi i grafikut nëpërmjet derivatit. Format e pacaktuara, rregulli i L'Hopital-it
28. Studimi i plotë i një funksioni nëpërmjet derivateve. Përsëritje
29. Problemet e optimizimit. Metoda e përafrimit të Njutonit. Antiderivatet
30. Sipërfaqet dhe distancat. Integrali i caktuar
31. Teorema themelore e kalkulusit. Integralet e pacaktuara. Metoda e zëvendësimit
32. Logaritmi i përcaktuar si integral. Përsëritje

Literatura baze dhe ndihmese:

- Kalkulus, T. Shaska, N. Pjerro
- Calculus, James Stewart (botimi i gjashte)

FORMAT E VLERESIMIT TE STUDENTEVE:

Kontrolli	Vleresimi ne perqindje
Kontrolli I	25 %
Kontrolli II	30%
Vlerësimi vjetor	10 %
Kontrolli final	35%

Vlerësimi me notë bëhet në bazë të konvertimit të vlerësimit total në %, nota 5-10 progresivisht 40-100%
Studenti, që rezulton me pak se 75% frekuentim për periudhën që i përket çdo provimi të pjesshëm, periudhe për të cilën do të testohet, nuk do te futet në provimin përkatës, do të vlerësohet me M.
Nëse studenti ka frekuentuar kursin, por nuk paraqitet në provimin e radhës vlerësohet NP (Nuk u Paraqit).

Formati i lëndës:

Lënda do të vlerësohet mbi bazën e dy provimeve të pjesëshme, detyrave si dhe provimit final. Pikët e marra do të jenë kumulative. Nuk do te ripërsëriten provimet, për asnjë motiv. Nëse ju do të humbisni një provim pa një arsye madhore, atëherë ju do të humbisni pikët për atë provim në të cilin nuk u paraqitët.

Komunikimi:
N.q.s. ju keni ndonjë problem apo pyetje, ju lutem dërgoni e-mail me subjektin “MAT 154”.
Telefonatat në numrin personal fiks apo cellular te pedagogut te lendes nuk janë të përshtatëshme: do t’ju luteshim të mos i përdorni ato. E-mail mund të zgjasë disa ditë për t’ju kthyer përgjigje. Shkruani subjektin “MAT 154” Urgjent” n.q.s problemi juaj është urgjent dhe nuk mund të presë. Studentet jane te lutur te mos dërgojnë e-mail që ka lidhje me kursin pa subjektin: MAT 154. Përpara se studentet të bëjnë një pyetje, të sigurohen se këtë informacion nuk e kanë gjetur në faqen zyrtare të internetit të UV. Studentet jane te lutur te mos drejtojnë nërpermjet email-it pyetje rreth përmbajtjes së kursit, pasi pyetjeve të tilla eshte mire tu jepet përgjigje në auditor, në praninë e një mase të gjerë studentësh.

Email: Çdo student e ka për detyrë të kontrollojë rregullisht e-mailin. Do te kete detyra dhe njoftime do të jepen vetëm nëpërmjet e-mailit.

Kodi i ndershmërisë:
Nuk lejohet puna në grupe për detyrat e shtëpisë, pasi ato janë individuale. Njëkohësisht nuk lejohet edhe kopjimi në provime, i cili ndëshkohet. Nuk lejohet përdorimi i telefonave celularë dhe pirja e duhanit në auditor.

SYLLABUS DET 215 Bazat e Njohjes së Anijes

Pedagogu: Msc. Gjergji Toskaj
Semestri Vjeshtë 2014
Ngarkesa javore: 3 lex/2sem
Kredite: 7

Objektivat e lëndes:
Lënda synon dhënien e njohurive mbi ndërtimin e anijes dhe mekanizmat e pajisjet kryesore të saj si dhe aftësimin e tyre për t'i përdorur ato në aktivitetin operacional të anijes.Gjithashtu njohja e sistemeve të ndryshme në anije dhe punimet për mirëmbajtjen e saj si një domosdoshmëri për rritjen e sigurisë e jetëgjatesisë së anijes.

Përmbajtja e lëndës:
Tema I: Temat që do trajtohen në leksione:

1. Dimensionet dhe karakteristikat e cilësite kryesore të anijes.
2. Llojet e klasifikimi i anijeve.
3. Ndërtimi dhe struktura e anijes.
4. Dyert e papërshkueshme, magregorët dhe pajisje të tjera ndihmuese.
5. Pajisjet takelazhe në anije.
6. Litarët në anije, llojet dhe ndërtimi i tyre si dhe qepja e lidhja e tyre.
7. Pajisjet ngritëse që përdoren në anije.
8. Pajisjet e bregëzimit e të rimorkimit në anije.
9. Ndërtimi i spirancës dhe mekanizmat e sistemit dhe gadina e spirancës.
10. Punimet për mirëmbajtjen e anijes, lyerja – përgatitja dhe organizimi.
11. Llojet e bojrave dhe instrumentet që përdoren.
12. Bovat, ndërtimi e shërbimi i tyre.
13. Timoni, ndërtimi dhe mekanizmat e timonit.
14. Disa nga mjetet e sistemet kryesore që përdoren në luftën ndaj ujitnë anije.
15. Disa nga mjetet e sistemet kryesore që përdoren në luftën ndaj zjarrit në anije.

Tema II: Temat që do trajtohen në seminare:

1. Cilat janë përmasat kryesore të anijes.
2. Cilësite kryesore të anijesj.
3. Veçoritëmbi të cilat klasifikohen anijet.
4. Pajisjet takelazhe tëanijes dhe përdorimi i tyre.
5. Llojet dhe ndërtimi i litarëve që përdoren në anije.
6. Teknikat për qepjen dhe lidhjen e litarëve.
7. Llojet e pajisjeve ngritëse në anije dhe veçoritë e përdorimit të tyre sipas llojit.
8. Ndërtimi e qëllimi i mjetve e pajisjeve të bregëzimit në anije.
9. Pjeset kryesore të sistemit të spirancës dhe qëllimi secilës prej tyre.
10. Ndërtimi dhe roli përdorimit të bovave.
11. Teknikat që përdoren për mirëmbajtjen e anijes.
12. Veçoritë e bojrave që përdoren në anije dhe lyerja me to.
13. Pjesët kryesore të sistemit të timonit dhe funksioni.
14. Vendosja në anije e sistemeve të luftës ndaj ujit në anije.
15. Vendosja në anije e sistemeve të mbrojtjes nga zjarri

Tema III : Temat që do trajtohen në detyrimet e tjera të lidhura me lëndën:, praktikë:

1. Disa nga seminaret për t'u konkretizuar dhe familjarizuar me anijen, zhvillohen direkt në bordin e anijes.

Literatura bazë dhe ndihmëse:

- Manuali i Oficerit të Kuvertës (Akademia e Detaris Vlorë 1995)
- IMO Model Course 7.03 (IMO London 2007)
- The Theory and Practice of Seamanship. (Danton, G. London, Routledge, 1996)
- Praktika Detare (Akademia e Detaris Vlorë 1995)
- Manuale di Manovra (Akademia Navale Livorno 2001)

FORMAT E VLERËSIMIT TË STUDENTËVE:

Kontrolli	Vlerësimi në përqindje

Kontrolli I	25 %
Kontrolli II	30%
Vleresimi vjetor +DK	10 %
Kontrolli final	35 %

Vlerësimi me notë bëhet në bazë të konvertimit të vlerësimit total në %, nota 5-10 progresivisht 41-100%
Studenti, që rezulton më pak se 75% frekuentim për periudhen që i përket çdo provimi të pjesshëm, periudhë për të cilën do të testohet, nuk do të futet në provimin përkatës, do të vlerësohet me M.
Nëse studenti ka frekuentuar kursin, por nuk paraqitet në provimin e radhës vlerësohet NP (Nuk u Paraqit).

Formati i lëndes:
Lënda do të vlerësohet mbi bazën e dy provimeve të pjesshme si dhe provimit final. Pikët e marra do të jenë kumulative. Nuk do të ripërsëriten provimet, për asnjë motiv. Nëse ju do të humbisni një provim pa një arsye madhore, atëherë ju do të humbisni pikët për atë provim në të cilin nuk u paraqitët.

Komunikimi:
Para fillimit të çdo ore mësimi ju mund të shtroni probleme apo pyetje, për paqartësi të mundëshme në lidhje me DET 215
Gjithashtu në ditët e Hëne ÷- e Enjte mund të drejtoheni pranë zyrës së Dep. Shk.Detare nga ora $10^{00} \div 11^{00}$.
Email: është mundësia tjetër e komunikimit për çdo detyrë, pyetje a probleme të ndryshme që lidhen me subjektin e lëndës

Kodi i ndershmërisë:
Nuk lejohet puna në grupe për detyrat e ndryshme, pasi ato janë individuale. Njëkohësisht nuk lejohet edhe kopjimi në provime, i cili ndëshkohet.

SYLLABUS DET 221 Drejtim Anije

Pedagogu: Msc. Gjergji Toskaj
Semestri Pranverë 2015
Ngarkesa javore: 3 lex/2sem
Kredite: 7

Objektivat e lëndës:
Lënda synon dhënien e njohurive dhe koncepteve bazë mbi artin e drejtimit dhe manovrimit të anijes.Njohja e cilësive manovruese të anijes dhe faktorëve që ndikojnë mbi të, rregullave të parandalimit të përplasjeve në det, lundrimi i anijes në kushte të ndryshme të hapësirës detare e atyre hidrometeorologjike si një domosdoshmëri për aftësimin e navigatorëve për të garantuar sigurinë e lundrimit në kushte e rrethana të çfardoshme.

Përmbajtja e lëndës:
Tema I: Temat që do trajtohen në leksione:

1. Ura e komandimit, shërbimi dhe proçedurat që ndiqen.
2. Faktorët qëndikojnë në drejtueshmërine e anijes.
3. Bashkëpunimi i grupit helikë-timon.Anijet me dy e më shumë helika.Pajisjet që përmirësojnë manovrueshmërinë e anijes.
4. Elementët manovrues të anijes.
5. Zgjedhja e vendqëndrimit në spirancë, llogaritjet për një qëndrim të sigurt të anijes në siprancë, mënyrat dhe manovrat për qëndrimin e anijes në spirancë e në bovë.
6. Manovrat për bregëzimin dhe ç'bregëzimin e anijes.
7. Studimi i rrugëkalimit të anijes dhe botimet lundrimore që përdoren për këtë qëllim.
8. Parandalimi përplasjeve ne det, parimet dhe termat që përdoren.
9. Rregullat gjatë lundrimit në kushte të çfardoshme.Rregullat gjatë lundrimit në dukje të njëra-tjetres dhe në dukshmëri të kufizuar.
10. Dritat dhe shenjat në anije.
11. Sinjalet me tinguj dhe me drita. Shtojcat dhe sinjalet e fatkeqësisë.
12. Lundrimi dhe manovrimi i anijeve në thellësi të vogla dhe kanale të ngushta si dhe në mot të keq, masat që merren
13. Rimorkimi, përgatitja dhe lundrimi e manovrimi i anijeve gjatë rimorkimit.
14. Rënia e anijes në cekinë, shkaqet, masat që merren dhe menyrat për nxjerrjen e anijes nga cekina.
15. Furnizimi në lundrim, parimet dhe manovrimi gjatë tij.

Tema II: Temat që do trajtohen në seminare:

1. Organizimi shërbimit dhe detyrat e personelit në urën e komandimit.
2. Si ndahen dhe ndikojnë faktorët e ndryshëm mbi drejtueshmërinë e anijes.
3. Veçoritë e bashkëpunimit helikë-timon në regjime të ndryshme të makinës.
4. Përcaktimi i elementeve manovrues të anijes.
5. Kushtet e qëndrimit në spirancë dhe menyrat e hedhjes së spirancës.
6. Mënyrat kryesore të bregëzimit të anijes.
7. Rrugëkalimi i anijes dhe çështjet që lidhen me të.
8. Rregullat e parandalimit të përplasjeve të anijeve në det.
9. Zbatimi rregullave në kushte të çfardoshme.
10. Testime lidhur me dritat dhe shenjat që mbahen nga anijet sipas llojit e gjendjes së tyre.
11. Përdorimi sinjaleve me tinguj për raste të ndryshme.
12. Shkaqet dhe pasojat në drejtimin e anijes gjatë lundrimit në thellësi tëvogla e hapësira të ngushta dhe veprimet për shmangien e tyre.
13. Masat qëmerren për shmangien e efekteve negative të motit të keq dhe hermetizimit të anijes.
14. Llojet e rimorkimit, organizimi për kryerjen e tij si dhe manovrimi gjatë tij.
15. Shkaqet e rënies së anijes në cekine, veprimet fillestare dhe mënyrat për ta nxjerrë atë.

Tema III : Temat që do trajtohen në detyrimet e tjera të lidhura me lëndën:, praktikë:

1. Disa nga seminaret për t'u konkretizuar dhe familjarizuar me anijen, zhvillohen direkt në bordin e anijes.

Literatura bazë dhe ndihmëse:

- Bazat e Drejtimit të Anijes (Akademia e Detarisë Vlorë- Tekst L.Gjika, K.Peci 1992)
- Parandalimi Përplasjeve në Det (U. "I.Q". Vlorë Tekst S.Jonuzi, Gj.Toska, 2008).
- IMO Model Course 7.03 (IMO London 2007)
- American Practical Navigator (Nathaniel Bowditch 2002)

- Manovrabilita della Nave (Accademia Navale Livorno 2001)
- Collision Regulation (IMO London 2007)

FORMAT E VLERËSIMIT TË STUDENTËVE:

Kontrolli	Vlerësimi në përqindje
Kontrolli I	25 %
Kontrolli II	30%
Vlerësimi vjetor +DK	10 %
Kontrolli final	35 %

Vlerësimi me notë bëhet në bazë të konvertimit të vlerësimit total në %, nota 5-10 progresivisht 41-100%
Studenti, që rezulton më pak se 75% frekuentim për periudhen që i përket çdo provimi të pjesshëm, periudhë për të cilën do të testohet, nuk do të futet në provimin përkatës, do të vlerësohet me M.
Nëse studenti ka frekuentuar kursin, por nuk paraqitet në provimin e radhës vlerësohet NP (Nuk u Paraqit).

Formati i lëndes:
Lënda do të vlerësohet mbi bazën e dy provimeve të pjesshme si dhe provimit final. Pikët e marra do të jenë kumulative. Nuk do të ripërsëriten provimet, për asnjë motiv. Nëse ju do të humbisni një provim pa një arsye madhore, atëherë ju do të humbisni pikët për atë provim në të cilin nuk u paraqitët.

Komunikimi:
Para fillimit të çdo ore mësimi ju mund të shtroni probleme apo pyetje, për paqartësi të mundëshme në lidhje me DET 221
Gjithashtu në ditët e Hëne ÷- e Enjte mund të drejtoheni pranë zyrës së Dep. Shk.Detare nga ora $10^{00} \div 11^{00}$.
Email: është mundësia tjetër e komunikimit për çdo detyrë, pyetje a probleme të ndryshme që lidhen me subjektin e lëndës

Kodi i ndershmërisë:
Nuk lejohet puna në grupe për detyrat e ndryshme, pasi ato janë individuale. Njëkohësisht nuk lejohet edhe kopjimi në provime, i cili ndëshkohet.

SYLLABUS DET 312 Astronomia Detare

Pedagogu: Msc. Gjergji Toskaj
Semestri Vjeshtë 2014
Ngarkesa javore: 3 lex/2sem
Kredite: 8

Objektivat e lëndes:
Lënda synon dhënien e njohurive dhe koncepteve bazë mbi orientimin dhe përcaktimin e vendodhjes së anijes me metodat astronomike në det të hapur e oqean. Kjo arrihet nëpërmjet njohjes së pozicionit të trupave të ndryshem qiellor, gjatë lëvizjes ditore të tyre, në një çast të caktuar kohor, të përcaktuar nga koordinatat sferike astronomike.Kalimi, nga ky pozicion i trupave në sferën qiellore, në përcaktimin në hartë të vendndodhjes së anijes, është objektivi që duhet të arrihet në përfundim të studimit të kësaj lënde.

Përmbajtja e lëndes:
Tema I: Temat që do trajtohen në leksione:

78. Sfera qiellore.
79. Sistemet e koordinatave qiellore.
80. Lëvizja ditore e dukshme e trupave qiellore.
81. Sistemi diellor.
82. Planetet, pozicioni dhe lëvizja e tyre.
83. Yjet dhe yjësitë kryesore, identifikimi i tyre nga harta yjore.
84. Ndryshimi i koordinatave ekuatoriale të trupave qiellore.
85. Hëna dhe lëvizjet e saj. Koha dhe matja e saj.
86. Vjetarët astronomik, përmbajtja struktura dhe përdorimi i tyre.
87. Globi yjor, yllkërkuesi dhe përdorimi i tyre.
88. Sekstanti, teoria dhe ndërtimi sekstantit detar.
89. Matja e lartësive me sekstant dhe korrigjimi i tyre.
90. Përcaktimi i korrigjimit të busullës me metoda astronomike.
91. Përcaktimi i vendndodhjes së anijes me 3-4 vija lartësore të vendndodhjes.
92. Përcaktimi i vendndodhjes së anijes me anë të matjes së dy lartësive të njëpasnjëshme të Diellit.Vija lartësore e vendndodhjes dhe gabimet e saj.

Tema II: Temat që do trajtohen në seminare:

33. Vijat dhe rrafshet bazë të sferës qiellore.
34. Ndërtimi sferës qiellore.
35. Përcaktimi trupave rreth polar e atyre që lindin e perëndojnë.
36. Interpretimi ligjeve të Keplerit
37. Përcaktimi deklinacionit të diellit e ditët e netët polare.
38. Gjetja e "moshës" së Hënës e koha e lindjes, kulmimit e perëndimit të saj.
39. Përcaktimi këndit orar e deklinacionit të trupave qiellorë me anë të vjetarëve astronomik.
40. Përcaktimi kohes së lindjes, kulmimit e perëndimit të trupave qiellorë me anë të vjetarëve astronomik.
41. Zgjidhje detyrash me yllkërkues.
42. Praktikimi i matjes së lartësisë me sekstant.
43. Korrigjimi i lartësive të matura me sekstant.
44. Gjetja e gabimit të busullës me metodat astronomike.
45. Zbatimi përcaktimit të vendndodhjes me anë të yjeve.
46. Zbatimi përcaktimit të vendndodhjes me anë të Diellit.
47. Hedhja e vijave lartësore të vendndodhjes në hartë.

Tema III : Temat që do trajtohen në detyrimet e tjera të lidhura me lëndën:, detyra kursi etj:

31. Përcaktimi vendndodhjes së anijes me anë të yjeve ose planetëve.
32. Përcaktimi vendndodhjes së anijes me anë të Diellit

Literatura bazë dhe ndihmëse:

- Astronomia Detare (Akad. Detaris Vlorë -Tekst V. Toçi 1987)
- IMO Model Course 7.03 (IMO London 2007)
- Nautical Almanac (London 2007)
- Fondamenti di Astronomia Nautica (IUT Napoli 1997
- American Practical Navigator (Nathaniel Bowditch 2002)
- Astronomia Nautica (Accademia Navale Livorno 2001)

FORMAT E VLERËSIMIT TËSTUDENTËVE:

Kontrolli	**Vlerësimi në përqindje**
Kontrolli I	25 %

Kontrolli II	25%
Vlerësimi vjetor +DK	15 %
Kontrolli final	35 %

Vlerësimi me notë bëhet në bazë të konvertimit të vlerësimit total në %, nota 5-10 progresivisht 41-100%
Studenti, që rezulton më pak se 75% frekuentim për periudhen që i përket çdo provimi të pjesshëm, periudhë për të cilën do të testohet, nuk do të futet në provimin përkatës, do të vlerësohet me M.
Nëse studenti ka frekuentuar kursin, por nuk paraqitet në provimin e radhës vlerësohet NP (Nuk u Paraqit).

Formati i lëndes:
Lënda do të vlerësohet mbi bazën e dy provimeve të pjesshme, detyrës së kursit si dhe provimit final. Pikët e marra do të jenë kumulative. Nuk do të ripërsëriten provimet, për asnjë motiv. Nëse ju do të humbisni një provim pa një arsye madhore, atëherë ju do të humbisni pikët për atë provim në të cilin nuk u paraqitët.

Komunikimi:
Para fillimit të çdo ore mësimi ju mund të shtroni probleme apo pyetje, për paqartësi të mundëshme në lidhje me DET 312
Gjithashtu në ditët e Hëne ÷- e Enjte mund të drejtoheni pranë zyrës së Dep. Shk.Detare nga ora $10^{00} \div 11^{00}$.
Email: është mundësia tjetër e komunikimit për çdo detyrë, pyetje a probleme të ndryshme që lidhen me subjektin e lëndës

Kodi i ndershmërisë:
Nuk lejohet puna në grupe për detyrat e ndryshme, pasi ato janë individuale. Njëkohësisht nuk lejohet edhe kopjimi në provime, i cili ndëshkohet.

SYLLABUS DET 211 Standartet e Sigurisë Detare

Pedagogu: Doc. Ermal Xheliaj
Semestri Vjeshtë 2014
Ngarkesa javore: 3 lex / 2 sem /
Kredite: 8

Objektivat e lëndës:

Të përcjell njohuri thelbësore te studentët në lidhje me sigurinë detare, dhe në vecanti të trajtoj cështje të rëndësishme si shpëtimi i jetës në det, njohja dhe përdorimi i pajisjeve detare të sigurisë së jetës, elementët kryesor të Konventës Ndërkombëtare mbi Shpëtimin e Jetës në Det 1974, ndihma ndaj personave të rrezikuar në det dhe anije gjatë lundrimit, teknikat e mbijetesës në det etj. Po ashtu ky program synon përcjelljen e njohurive kryesore në lidhje me operacionet e kërkim-shpëtimit (SAR), përdorimin e Manualit të Kërkim-Shpëtimit të IMO-s, mbrojtjen dhe sigurinë e jetës së personave në anijet pasagjere, si dhe pajisjet dhe sistemet dixhitale për fatkeqësitë detare EPRIB dhe SART.

Përmbajtja e lëndës:

Tema I: Njohuri të përgjithshme për Konventën Ndërkombëtare mbi Shpëtimin e Jetës në Det, 1974/78 (SOLAS).
- Pajisjet personale të shpëtimit të jetës në anijet pasagjere dhe tregtare.
- Teknikat e përgjithshme të mbijetesës në det.
- Teknikat personale të mbijetesës dhe shpëtimit në det.

Tema II: Njohja me pajisjen satelitore EPIRB.
- Njohja me aparaturen elektronike të kërkim shpëtimit SART.
- Instruksionet e përdorimit dhe të emergjencës te pajisjet e shpëtimit.

Tema III: Njohuri lidhur me lancat dhe trapet e shpëtimit dhe të mbijetesës në anije.
- Zadrat e shpëtimit dhe elementët kryesorë të tyre.
- Trapet pneumatik në anije.
- Përgatitja e imbarkacionit për në lancat e shpëtimit dhe të mbijetesës.
- Stacionet e hedhjes së lancave të shpëtimit dhe mbijetesës në anije.
- Magazinimi dhe ruajtja e lancave të shpëtimit dhe pajisjeve të mbijetesës në anije.
- Supervizimi dhe përdorimi i lancave të shpëtimit dhe të mbijetesës.

Tema IV: Hipotermia dhe pasojat e saj mbi njerëzit në rrezik.
- Llojet e Hipotermisë dhe masat kundër tyre.
- Problematikat mbi hipoterminë

Tema V: Radio komunikimi lidhur me fatkeqësitë detare dhe shpëtimin e personave.
- Njohja dhe përdorimi i pajisjeve satelitore të fatkeqësive detare SART.
- Sistemet e evakuimit të personave në anije.
- Strategjitë e kapjes së personave të rënë në det.

Tema VI: Kostumet e zhytjes në det dhe pajisjet mbrojtëse termike e personale.
- Rrathët e shpëtimit në anije.
- Jelekët e shpëtimit dhe parametrat bazë të tyre.
- Pajisjet e shtytjes dhe hedhjes së cimave në anije dhe lanca shpëtimi.

Tema VII: Trajnimi dhe ushtrimet e emergjencës në anije.
- Procedurat dhe organizimi i braktisjes së anijes në fatkeqësi.
- Masat parandaluese për mbrojtjen dhe sigurinë e pasagjerëve në anije.
- Shpëtimi i personave në anije me avari, pa drejtim dhe në fatkeqësi.

Tema VIII: Ulja e helikopterëve të shpëtimit në det dhe marrja e personave në bord.
- Planet e emergjencës mbi shpëtimin e personave në anije.
- Shpëtimi i personave dhe planet e emergjencës në anijet RO-RO.
- Shpëtimi i personave dhe planet e emergjencës në anijet LNG dhe Oil Tanker.
- Shpëtimi i personave gjatë operacioneve portuale të anijeve.

Tema IX: Krijimi i kulturës së sigurisë detare dhe shpëtimit të jetës në det.
- Certifikatat për pajisjet e shpëtimit/ radiot e shpëtimit në anije dhe lancat.
- Njohuri mbi Konventën Ndërkombëtare të Kërkim-Shpëtimit në Det.

Tema X: Strategjitë dhe operacionet e kërkim-shpëtimit në det.
- Manuali i Kërkim-Shpëtimit të Anijeve Tregtare, IMO.
- Organizimi i Kërkim-Shpëtimit në Shqipëri.
- Sistemi Global Satelitor i Fatkeqësive në Det (GMDSS)

Literatura bazë dhe ndihmëse:

International Maritime Organization (2004). *Consolidated text of the International Convention for the Safety of Life at Sea, 1974, and its Protocol of 1988: articles, annexes and certificates,* IMO Publication, London, UK

International Maritime Organization (1979). *Merchant Ship Search and Rescue Manual MERSAR,* IMO Publication, London, UK

International Maritime Organization (2004). *International Convention on Maritime Search and Rescue, 1979* , IMO Publication, London, UK

International Maritime Organization (2006 *). Operate life saving appliances (IMO MC 1.23),* IMO Publication, London, UK

International Maritime Organization (2000). *Search and Rescue Transponder (SART),* IMO Publication, London, UK

FORMAT E VLERËSIMIT TË STUDENTËVE:

Kontrolli	Vlerësimi në përqindje
Kontrolli I	25 %
Kontrolli II	30 %
Vleresimi vjetor	10 %
Kontrolli final	35 %

Vlerësimi me notë bëhet në bazë të konvertimit të vlerësimit total në %, nota 5-10 progresivisht 41-100%
Studenti, që rezulton më pak se 75% frekuentim për periudhën që i përket cdo provimi të pjesshëm, periudhë për të cilën do të testohet, nuk do të futet në provimin përkatës, do të vlerësohet me M.
Nëse studenti ka frekuentuar kursin, por nuk paraqitet në provimin e radhës vlerësohet NP (Nuk u Paraqit).

Formati i lëndës:
Lënda do të vlerësohet mbi bazën e dy provimeve të pjesëshme, detyrave si dhe provimi final. Pikët e marra do të jenë kumulative. Nuk do te ripërsëriten provimet, për asnje motiv. Nese ju do të humbisni një provim pa një arsye madhore, atëherë ju do të humbisni pikët për atë provim në të cilin nuk u paraqitët.

Komunikimi:
N.q.s. ju keni ndonjë problem apo pyetje, ju lutem dërgoni e-mail me subjektin “MKT 110”.
Telefonatat në numrin personal fiks apo cellular te pedagogut te lendes nuk janë të përshtatëshme: do t’ju luteshim të mos i përdorni ato. E-mail mund të zgjasë disa ditë për t’ju kthyer përgjigje. Shkruani subjektin “MKT 110” Urgjent” n.q.s problemi juaj është urgjent dhe nuk mund të presë. Studentet jane te lutur te mos dërgojnë e-mail që ka lidhje me kursin pa subjektin: MKT 110. Përpara se studentet të bëjnë një pyetje, të sigurohen se këtë informacion nuk e kanë gjetur në faqen zyrtare të internetit të UV. Studentet jane te lutur te mos drejtojnë nërpermjet email-it pyetje rreth përmbajtjes së kursit, pasi pyetjeve të tilla eshte mire tu jepet përgjigje në auditor, në praninë e një mase të gjerë studentësh.

Email: Çdo student e ka për detyrë të kontrollojë rregullisht e-mailin. Do te kete detyra dhe njoftime do të jepen vetëm nëpërmjet e-mailit.

Kodi i ndershmërisë:
Nuk lejohet puna në grupe për detyrat e shtëpisë, pasi ato janë individuale. Njëkohësisht nuk lejohet edhe kopjimi në provime, i cili ndëshkohet.

SYLLABUS Kim 143 Kimi e përgjithshme

Pedagogu: Prof.As.Dr. Petrit Kotori
Semestri Vjeshtë 2014
Ngarkesa javore: 3 lex / 2 sem / 0 lab
Kredite: 8

Objektivat e lëndës:

Lënda e Kimisë së Përgjitheshme synon që t'u japë studentëve të Fakultettit të Shkencave Teknike njohuri bazë mbi lëndën, elementët dhe substancat kimike. Gjatë leksioneve dhe seminareve bëhet një rishikim më i avancuar i njohurive të marra në Shkollën e Mesme të Përgjitheshme në lëndën e Kimisë, kurse për ata studentë që vijnë nga Shkollat e Mesme Profesionale synohen të jepen që në fillim dhe njohuritë bazë të Kimisë së Përgjitheshme.

Ky program synon të japë një formim të përgjithshëm për të interpretuar fenomenet kimike dhe për të thelluar njohuritë me karakter kimik që mund t'u paraqiten gjatë viteve të studimit dhe në aktivitetin e tyre profesional. Në program janë përfshirë:
